PRILL 2021

# BLLOKU I SHËNIMEVE
## PËR KONFERENCËN E PËRGJITHSHME





**UDHËZUESI JUAJ PËR TË MARRË ZBULESË VETJAKE TEKSA MERRNI PJESË NË KONFERENCËN E PËRGJITHSHME**

# Frymëzimi
# FILLON KËTU.

Konferenca e përgjithshme është një mundësi e përsosur që Zoti t'ju flasë drejtpërsëdrejti. Ndërkohë që shërbëtorët e Zotit flasin, Fryma e Shenjtë do të dëshmojë për Jezu Krishtin (shih Gjoni 15:26) dhe do t'ju mësojë "të gjitha gjërat që ju duhet të bëni" (2 Nefi 32:3). Përfytyroni që, teksa e dëgjoni plot lutje dhe plot zell atë që thonë folësit, Zoti mund t'ju japë zbulesë të personalizuar! Ai do t'ju tregojë se çfarë dëshiron Ai që ju të dini dhe çfarë ka nevojë Ai që ju të bëni. Skema më poshtë tregon se si mund të funksionojë kjo:

**PRA, FILLONI TË PËRGATITENI TANI PËR T'IU BASHKUAR NISMËS #DËGJOJEATË.**

- Lutuni që ta keni Frymën e Shenjtë për t'ju frymëzuar.
- Shkruani çfarëdo pyetje që mund të keni.
- Bëni një plan që të dëgjoni ose të lexoni sa më shumë që të mundeni nga konferenca e përgjithshme.



**MBANI VESH PËR "ZËRI[N E] ZOTIT" TEKSA E DËGJONI ÇDO FOLËS**
(shih Doktrina e Besëlidhje 68:3–4).



**FRYMA E SHENJTË DO TË FLASË NË ZEMRËN DHE MENDJEN TUAJ**
(shih Doktrina e Besëlidhje 8:2–3).

**SHKRUAJINI MBRESAT QË MERRNI**
(shih 2 Nefi 29:11).



**VEPRONI SIPAS ASAJ QË MËSONI DHE NDIENI**
(shih Gjoni 7:17; 1 Nefi 3:7).

# SESIONI I PARADITES të së Shtunës

Zoti i ka frymëzuar të gjithë folësit me mesazhe të posaçme që Ai do që ata t'i tregojnë. Ai do të japë gjithashtu mesazhe nëpërmjet Frymës së Shenjtë, që janë përshtatur enkas për ju. Mbani vesh për të dyja teksa merrni pjesë në konferencën e përgjithshme.

**ÇFARË MËSOVA SOT RRETH JEZU KRISHTIT?**

Çfarë ndiej se Zoti po përpiqet të më mësojë?

**"QËLLIMI I KËSAJ KONFERENCE DHE I ÇDO KONFERENCE TË PËRGJITHSHME, ËSHTË QË TË NA NDIHMOJNË TA DËGJOJMË ATË."**

Presidenti Rasëll M. Nelson[1]

Çfarë mesazhesh më bënë përshtypje? Përse?



Çfarë do të bëj tani?

# SESIONI I PASDITES
## të së Shtunës

Kur i shkruani mbresat që merrni në konferencën e përgjithshme, ju i tregoni Zotit dëshirën tuaj për të marrë mësim nga Ai. Kur veproni sipas asaj që Ai ju mëson, ju do të bëheni më shumë si Ai.

**ÇFARË NDIEJ SE KAM NEVOJË TË BËJ PËR T'IU AFRUAR MË SHUMË SHPËTIMTARIT?**

# SESIONI I MBRËMJES të së Shtunës

Lutuni që Fryma e Shenjtë t'ju mësojë teksa merrni pjesë në konferencën e përgjithshme. Ai do t'ju japë ide që janë posaçërisht për ju. Shënojini këto mbresa dhe bëni një plan që të veproni sipas tyre.





## ÇFARË U FTOVA TË BËJ QË DO TË MË NDIHMOJË TË JEM MË SHUMË SI JEZU KRISHTI?



**"AJO QË *THUHET* NUK ËSHTË AQ E RËNDËSISHME SA AJO QË *DËGJOJMË* DHE AJO QË *NDIEJMË*."**

Plaku Robert D. Hejls[2]

# SESIONI I PARADITES të së Dielës

Kur i dëgjoni apo i lexoni mesazhet në konferencën e përgjithshme, shënojini mbresat shpirtërore që merrni. Çfarë të vërtetash jepen mësim? Çfarë është më e rëndësishmja për ju?

**SI E NDJEVA DASHURINË E SHPËTIMTARIT GJATË KËTIJ SESIONI?**







**"ÇASTET QË TË PËRCAKTOJNË SHPIRTËRISHT, VIJNË TEKSA NE E DËGJOJMË PLOT LUTJE KONFERENCËN E PËRGJITHSHME DHE TEKSA I ZBATOJMË MË MIRË URDHËRIMET."**

Plaku Nil L. Andersen[3]

# SESIONI I PASDITES të së Dielës

Është e rëndësishme t'i dëgjomë mesazhet që çdo folës po i jep mësim. Është po aq e rëndësishme t'i dëgjojmë mesazhet që Fryma e Shenjtë po përpiqet t'jua mësojë.

## ÇFARË MËSOVA UNË RRETH SHLYERJES SË JEZU KRISHTIT?

**"ATA QË DO TË NA FLASIN NEVE, KANË KËRKUAR NDIHMËN DHE DREJTIMIN NGA QIELLI, KUR KANË PËRGATITUR MESAZHET E TYRE. . . .""QË NE TË MUND TË MBUSHEMI ME SHPIRTIN E ZOTIT, NDËRSA DËGJOJMË E MËSOJMË, ËSHTË LUTJA IME."**

Presidenti Tomas S. Monson[4]

# STACIONI i Zbavitjes

## A Mund ta Gjeni Përkimin?

Më poshtë janë çifte figurash që gjenden te shkrimet e shenjta. Përdorini këto vargje për t'ju ndihmuar që t'i përkoni gjërat në të majtë me ato në të djathtë.

- Doktrina e Besëlidhje 20:77, 79
- Alma 32:26–30
- Gjoni 10:14–15
- 1 Samuelit 17:38–40, 46–50
- Marku 6:34–44



## Sfida e Tangramit

Tangramet janë figurëformuese të lashta kineze. Pritini format në të majtë dhe shikoni nëse mund ta rikrijoni statujën e engjëllit Moroni, qiriun dhe pëllumbin që tregohen këtu. A mund të krijoni figura të tjera?







## Lidhuni me aparate elektronike për Konferencën

Merrni parasysh çdo kordon aparati elektronik që të lidheni në mënyra të ndryshme për të marrë pjesë në konferencë.

# Pra, **PO TANI?**

Konferenca e përgjithshme mund të ketë mbaruar, por përvoja juaj me atë që mësuat, është vetëm fillimi. Çfarë do të bëni për të vepruar sipas asaj që dëgjuat dhe ndiet? Ndoshta ju ndieni se keni shumë gjëra me të cilat mund të punoni, por nuk mund t'i bëni të gjitha njëherësh. Këtu janë disa pyetje që t'ju ndihmojnë të planifikoni hapat tuaj të radhës:

**1.** Çfarë u ndiet i/e frymëzuar të vazhdoni të bëni ose të ndryshoni në jetën tuaj?

**2.** Cilat prej këtyre mendoni se janë gjërat më të rëndësishme sipas të cilave të veproni tani?

**3.** Çfarë synimesh mund të vendosni ose ndaj cilave mund të zotoheni sërish?

**4.** Kujt mund t'i kërkoni që t'ju ndihmojë?

SHËNIME

1. Rasëll M. Nelson, "Mesazhi i Hapjes", konferenca e përgjithshme e prillit 2020 (*Ensign* ose *Liahona*, maj 2020, f. 7).
2. Robert D. Hejls, konferenca e përgjithshme e tetorit 2013 (*Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2013, f. 6).
3. Nil L. Andersen, konferenca e përgjithshme e prillit 2020 (*Ensign* ose *Liahona*, maj 2020, f. 21).
4. Tomas S. Monson, "Mirësevini në Konferencë", konferenca e përgjithshme e tetorit 2009 (*Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2009, f. 6).
5. M. Rasëll Ballard, konferenca e përgjithshme e prillit 2020 (*Ensign* ose *Liahona*, maj 2020, f. 11).

## FRYMËZIM PËR JU

**"NDËRSA E DËGJOJMË SHPIRTIN . . . KËTË FUNDJAVË, MERRNI PARASYSH SE ÇFARË BLATIMI DO T'I PARAQITNI ZOTIT ME DREJTËSI NË DITËT E ARDHSHME. JINI TË GUXIMSHËM – TREGOJINI PËR TË DIKUJT TË CILIT I MIRËBESONI DHE, MË E RËNDËSISHMJA, JU LUTEMI GJENI KOHË PËR TA BËRË ATË!"**

Presidenti M. Rasëll Ballard[5]

## KENI NEVOJË PËR MË SHUMË KOPJE?

Shkarkojeni dhe shtypeni në letër këtë bllok shënimesh te **conference.ChurchofJesusChrist.org**.

© 2021 by Intellectual Reserve, Inc. All rights reserved.

Leja për ta rishtypur në letër këtë broshurë jepet për përdorim vetjak, jo për tregti. Kjo përfshin lejen për udhëheqësit e lagjes, për të shtypur në letër një numër të vogël kopjesh, për ata që shërbejnë brenda kuadrit të thirrjeve të tyre. Broshurat duhet të shtypen të plota. Kjo nuk përfshin lejen që ky material të afishohet në internet, të ripërdoret ose të shpërndahet. Çdo përdorim shtesë i këtij materiali kërkon leje.

**permissions.ChurchofJesusChrist.org**

KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME